

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7086
E martë, 9 janar 2024
Çmimi 0.50

BE-ja: Ky vit sjell shpresë
të re për zbatimin e
marrëveshjeve në mes të
Kosovës dhe Serbisë | FAQE 6



INTERVISTË ESKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së
SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (20) | FAQE 4-5

QEVERIA E PËRKOHSHME DHE PËRFUNDIMI I LUFTËS



Politologu Bardhyll Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së njëzetë, ka folur për krijimin e Qeverisë së Përkoohshme, e cila i dha fund përfaqësimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

nëpërmjet përfaqësuesve të vet politikë. Bardhyll Mahmuti ka theksuar se shumica e anëtarëve të Drejtorisë Politike dhe të Grupit Diplomatik u sisteman në detyra të ndryshme të Qeverisë së Përkoohshme. Ai ka folur për takimet e delegacionit të Qeverisë së Përkoohshme jashtë vendit, ku

edhe vetë ishte pjesë e delegacioneve. Bardhyll Mahmuti ka treguar se nga data 14-17 prill 1999 qëndruan për vizitë zyrtare në Francë. Gjatë kësaj kohe ata kanë realizuar 24 takime të rëndësishme në institucione të ndryshme dhe aty nuk munguan duartrokitjet e brohoritjet: UÇK-UÇK

SPANJA NJEH PASAPORTAT E KOSOVËS



HARADINAJ,
AKUZA PËR
QEVERINË KURTI:
DËSHTIME NË ÇDO
SEGMENT TË JËTËS
E TË POLITIKËS



RENOVA
PUTZ

Maqedoni
Xheqçishti - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com
Gazeta "Epoka e re"](https://facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



AKTUALE



AVIONËT LUFTARAKË AMERIKANË MBI
BOSNJË NË PRAG TË AKTIVITETEVE
NDARËSE DHE ANTI-DEJTON

F. 2
ÇMIMET E LARTA, EKSPERTËT
KËRKOJNË POLITIKA MË TË MIRA
FISKALE QË TË BIE INFLACIONI

F. 7
55 AKSIDENTE NË KOSOVË NË 24
ORËT E FUNDIT




VTRANICA: GASTRONOMIA,
MË E RREZIKUARA NGA IKJA
E PUNËTORËVE

F. 8
BUJOIT GJERMANË I BLLOKOJNË
RRUGËT, KUNDËR NDALJES
SË SUBVENCIONEVE



Franz Beckenbauer
1945 - 2024
NDËRRON JETË LEGJENDA FRANZ
BECKENBAUER

SPORT



INFINITY
Digital Agency

Internet Website,
Marketing...

**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Endrit Shaqiri
+38344685122

Avionët luftarakë amerikanë mbi Bosnjë në prag të aktiviteteve ndarëse dhe anti-Dejton

BRČKO, 8 JANAR - Dy avionë luftarakë F-16 të Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara (ShBA) kryen stërvitje mbi qytetet Brčko dhe Tuzla në pjesën veriore të Bosnjë-Hercegovinës pasditen e së hënës, njëtojtë Ambasada e ShBA-së në Bosnjë-Hercegovinë.

Avionët luftarakë amerikanë fluturuan mbi Bosnjë-Hercegovinë në prag të festimit të një festë antikushtetuese më 9 janar në entitetin e Republikës Sërpshka.

Në njoftim thuhet se trajnimi dypalësh "tregon përkushtimin e Shteteve të Bashkuara ndaj integritetit territorial të Bosnjë-Hercegovinës në vazhdën e aktiviteteve ndarëse dhe anti-Dejon". "Shtetet e Bashkuara theksojnë vazhdimisht se Kushtetuta e Bosnjë-Hercegovinës nuk parashikon të drejtën e shkëputjes dhe se do të veprojë nëse dikush përpinqet të ndryshojë këtë element bazë të Dejtonit", thuhet në deklaratën e Ambasadës Amerikane.

Ajo shtoi se Bosnja e Hercegovina është partnerë kyçë e ShBA-së dhe se ato kanë synim të përbashkët sigurimin e stabilitetit rajonal. "Ky mision do të mbështetet nga avioni KC-135 Stratotanker, i cili do të sigurojë furnizim me karburant në ajër për avionët F-16 mbi

territorin e entitetit të Republikës Sërpshka në Bosnjë-Hercegovinë", tha ajo.

Ky trajnim zhvillohet në kuadër të aktiviteteve të Forcave të Armatosura Amerikane për shkëmbimin e taktikave, metodave dhe procedurave operacionale me Forcat e Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës.

Deklarata, gjithashtu, thekson se njësia e Forcave Ajrore të ShBA-së për Evropën dhe Afrikën angazhohen rregullisht ushtarakisht me partnerët rajonalë me qëllim të ofrimit të trajnimit, përmirësimit të ndërveprimit dhe demonstrimit të një angazhimi të përbashkët për të njëjtat qëllime sigurie.

"Aeroplani amerikan do të kthehet në bazë menjëherë pas përfundimit të misionit. Aftësia për të vendosur shpejt, për ta lokalizuar objektivin dhe për t'u kthyer në bazë tregon aftësinë e ShBA-së për të projektuar fuqi kudo në kohën më të shkurtër të mundshme dhe për të vepruar së bashku me aleatët dhe partnerët", thuhet në komunikatë.

F-16 është një avion i lehtë luftarak që hyri në shërbim për herë të parë në vitin 1979. Forcat Ajrore të ShBA-së e përdorën atë gjérësisht në të dy luftërat në Irak, si dhe gjatë



luftës në Afganistan.

Më shumë se 4 600 avionë F-16 u ndërtuan në vitin 1976, kur prodhimi u miratua zyrtarisht.

Udhëheqja politike e Republikës Sërpshka, e udhëhequr nga presidenti i saj, Millorad Dodik, e kërkon zëshëm shkëputjen apo ndarjen e këtij entiteti nga Bosnjë-Hercegovina.

Kjo është kundërshtuar nga

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe vendevë të tjera në Bosnjë e Hercegovinë. "Millorad Dodik e ka gabim nëse mendon se Shtetet e Bashkuara do të qëndrojnë duarkryq derisa ai e shtyn Bosnjë-Hercegovinën drejt konfliktit", tha Ambasada amerikane më 28 dhjetor 2023. Ajo tha se Republika Sërpshka është

një entitet brenda shtetit të Bosnjë-Hercegovinës dhe se Kushtetuta e shtetit nuk parashikon të drejtën e një entiteti për t'u shkëputur. "Shtetet e Bashkuara e kanë bërë të qartë në disa raste se do të veprojnë për t'i kundërshtuar veprimet kundër Dejtonit dhe shkëputja është një veprim kundër Dejtonit", tha ambasada amerikane.

Perëndimi kërkon t'i japë fund shpejt luftës në Gazë



GAZA, 8 JANAR - Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre në grupin e shtatë shteteve më të industrializuara (G7) janë duke kërkuar ta gjejnë një mënyrë të shpejtë për t'i dhënë fund luftës në konfliktin e Rripit të Gazës, tha Italia të hënën, derisa sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, dhe homologët e tij nga Bashkimi Evropian po e vizitojnë rajonin.

Blinkeni mbajti takime për Gazën në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe në Arabinë Saudite të hënën, para se të nisej për Izrael, duke synuar t'i nisë përpjekjet për paqe konkrete, për të cilat thotë se janë të nevojshme për ta parandaluar një luftë më të gjëre.

Ai e nisi një vizitë pesëditore në Lindjen e Mesme të dielën në Jordani dhe në Katar. Kjo është vizita e tij e katërt në rajon prej sulmit të 7 tectorit, kur Izraeli u sulmuva nga Hamasi - grupei palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja, i cili edhe e nxiti Izraelin ta fillojë luftën që nuk po tregon shenja përfundimi.

Ministria e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, e vizitoi Izraelin të hënën, ndërsa

kryediplomati i BE-së, Josep Borrell, e vizitoi Libanin. "Vendet e G7-s po punojnë me Qeverinë e Izraelit për ta gjetur një mënyrë të shpejtë për t'i dhënë fund fazës ushtarake", tha ministri i Jashtëm i Italisë, Antonio Tajani, pasi Italia e nisi kryesimin njëveçar të G7-s. Baerbock, ndërkokë, i tha Izraelit se e ka për detyrë t'i mbrojë

palestinezët në Bregun e uzurpuar Perëndimor, pasi Blinkeni paralajmëroi për zgjerim të konfliktit të dielën në Doha. "Ky është një konflikt i cili shumë lehtë mund të përhapet", tha Blinken.

Ministri i Mbrojtjes i Izraelit, Yoav Gallant, tha se vendi i tij është i përkushtuar t'i japë fund sundimit

të Hamasit në Gazë dhe t'i frenojë grupet e tjera të mundshme që mbështeten nga Irani, siç është Hezbollahu. "Ne jemi duke luftuar me një strumbull, jo një armik të vetëm. Irani po e rrit fuqinë ushtarake përreth Izraelit në mënyrë që ta përdorë atë", tha Gallant.

Të hënën në mëngjes ushtria

izraelite u bëri thirrje banorëve në Al Moghani në qendër të Gazës të evakuohen nga disa rrethina, për të cilat tha se "janë zona të rezikshme lufte".

Gati të gjithë banorët e Gazës prej 2.3 milionësh janë zhvendosur nga shtëpitë e veta në luftë së pakunjë herë dhe shumë prej tyre po zhvendosen sërisht, shpesh duke u strehuar në tenda.

Izraeli, ofensiva e të cilat gjithashtu ka shkaktuar mungesë ushqimi, uji dhe ilaçesh, i akuzon luftëtarët e Hamasit se me qëllim i përdorin civilët si mburojë njerëzore, akuza të cilat ata i mohojnë.

Blinkeni tha se ai do t'u kërkojë zyrtarëve izraelitë të bëjnë më shumë për t'i mbrojtur civilët në Gazë dhe për t'i lejuar palestinezët të kthehen në shtëpitë e tyre.

Më shumë se 23 000 palestinezë janë vrarë në Gazë gjatë ofensivës izraelite, sipas Ministrisë palestinezë të Shëndetësisë.

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka paralajmëruar se lufta nuk do të ndalet derisa Hamasi i kthejë më shumë se 100 pengjet që është duke i mbajtur ende, nga 240 që i rrëmbeu gjatë sulmit të 7 tectorit në jug të Izraelit, ku i vran, po ashtu, 1 200 njerëz.

Kurti: Java e parë e vitit të ri ka qenë javë e fillimeve të reja për qytetarët dhe shtetin

PRISHTINË, 8 JANAR - Kryeministri Albin Kurti ka thënë se java e parë e vitit të ri ka qenë javë e fillimeve të reja për qytetarët dhe shtetin tonë. "Për herë të parë mund të udhëtojmë në Zonën Shengen pa viza. Targave ilegale të Serbisë u erdhi fundi 24 vjet pas çlirimt, e targat RKS u njoftën nga Serbia 15 vjet pas shpalljes së Pavarësisë. Filloi regjistrimi i

energjisë elektrike në katër komunat në veri të vendit, pas më shumë se dy dekadave. Ndërkohq në prag të 16-vjetorit të Pavarësisë, Spanja iu bashkua shteteve të Bashkimit Evropian që e njoftin pasaportën e Kosovës", ka shkruar Kurti në "Facebook". Ai ka thënë se fillimet që po i shënojmë e festojmë tanë, janë rezultate të një pune të gjatë e

vendosmërie të madhe të institucioneve tona që vazhdon edhe më tej. "Falënderoj të gjithë kabinetet politike dhe punonjësit e shtetit dhe qeverisë për kontributin e tyre dhe partnerët tanë ndërkombëtarë për rolin që kanë luajtur. Por më së shumti qytetarët e vendit tonë që na besuan dje dhe që na mbështesin sot e çdo ditë", ka shkruar Kurti.



Spanja njeh pasaportat e Kosovës



EPOKA
ERE

Faton DERMaku

PRISHTINË, 8 JANAR - Spanja ka njoftuar pasaportat e Kosovës, duke u mundësuar qytetarëve të Kosovës të udhëtojnë pa viza edhe në këtë shtet, sipas një dokumenti të publikuar më 5 janar në uebfaqen e Departamentit për Migrim dhe Çështje të Brendshme të Komisionit Evropian. Në dokumentin e publikuar thuhet se "nga 1 janari Spanja njeh pasaportat e zakonshme të lëshuara nga Kosova". "Kjo nuk nënkupton në asnjë formë njohje zyrtare të Kosovës si shtet i

pavarur", thuhet në dokument. Që nga 1 janari shtetasit e Kosovës me pasaporta biometrike mund të udhëtojnë në shtetet e Zonës Shengen pas hyrjes në fuqi të vendimit për liberalizimin e vizave. Më herët, gjatë 6 janarit, zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se Spanja i shtohet listës së shteteve që kosovarët mund të vizitojnë pa pasur nevojë të pajisen me vizë. "Ndërsa më 1 janar nisi lëvizja pa viza, Spanja është destinacion që u shtohet vendeve të zonës Schengen ku mund të udhëtojmë përmes liberalizimit, e ku pengesë më herët ishte

mosnjohja e pasaportës sonë", ka shkruar Bislimi në "Facebook". Ndërkohq ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla, në rrjete sociale ka falënderuar Madridin zyrtar, në gjuhën spanjolle, për këtë vendim. Vendimi për liberalizimin e vizave në Zonën Shengen hyri në fuqi më 1 janar dhe nga 27 shtate, ku kosovarët mund të udhëtonin pa viza, përfashim bënte vetëm Spanja. Sipas Gërvallës, në bazë të njofitimit nga shtetet anëtare të BE-së - që ka të bëjë me dokumentet e udhëtimit - deri më 5 janar 2024 Mbretëria e

Spanjës i është shtuar listës që njoftin pasaportat e zakonshme të Kosovës.

Spanja është në mesin e pesë shteteve të BE-së që nuk e njoftin pavarësinë e Kosovës, e ku bëjnë pjesë edhe Greqia, Qiproja, Sllovenia dhe Rumania. Megjithatë, të gjitha këto shtete njoftin dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga autoritetet në Kosovë.

Liberalizimi i vizave u mundëson qytetarëve të Kosovës, që kanë pasaporta biometrike, të qëndrojnë deri në 90 ditë brenda gjashtë muajsh në cilindro nga 27 shtetet anëtare të Zonës Shengen.

Udhëtimet pa viza shërbejnë përvizita turistike, çështje familjare ose të ngjashme. Megjithatë, liberalizimi i vizave nuk nënkupton leje pune apo përfitimi të tjera.

Kosova ishte vendi i fundit i Ballkanit Perëndimor qytetarët e të cilit deri më 1 janar të këtij viti nuk mund të lëviznin lirshëm në Zonën Shengen. Kjo pavarësisht faktit se që nga viti 2018 Komisioni Evropian kishte konfirmuar disa herë që Kosova kishte përbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por që disa shtete vazhdimisht kishin shprehur rezerva.

Haradinaj me akuza për qeverinë Kurti: Dështime në çdo segment të jetës e të politikës

PRISHTINË, 8 JANAR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se nuk mbahet mend që Kosova ta ketë pasur një vit më të humbur sesa vitin 2023. Sipas tij, ka pasur dështime në çdo segment të jetës e të politikës.

Haradinaj ka thënë se me këtë qeveri po ndodh regres në pozicionin ndërkombëtar të Kosovës, sanksione e ndëshkime nga aleatët strategjikë, asnjë njojje, asnjë investim i huaj, disfatizëm në raport me Serbinë e rrezikim i pavarësisë së vitit 2008; rritje enorme e çmimeve në artikujt elementarë, në energji, në tatime, në artikujt bazë ushqimor; dështim në investime e në zhvillim ekonomik; në arsim e në shëndetësi; me pagat më të ulëta në rajon; me afera të pazbardhura korruptive me rezervat shtetërore e tregtimin

e energjisë; me luftë të paskrupullt ndaj gjyqësorit, me largimin masiv të rinisë nga vendi, e kështu me radhë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Për të shtuar tutje se: "Natyrisht edhe me pafytyrësinë e qeverisë që të gjitha këto dështime t'i paraqesë si suksese. Të gjitha këto dështime nuk mund të kalojnë pa ndëshkim. Prandaj sot, më shumë se kurrë, kërkohet unitet e mobilizim që të ndalet rënia e shoqërisë dhe e shtetit".

e energjisë; me luftë të paskrupullt ndaj gjyqësorit, me largimin masiv të rinisë nga vendi, e kështu me radhë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Për të shtuar tutje se: "Natyrisht edhe me pafytyrësinë e qeverisë që të gjitha këto dështime t'i paraqesë si suksese. Të gjitha këto dështime nuk mund të kalojnë pa ndëshkim. Prandaj sot, më shumë se kurrë, kërkohet unitet e mobilizim që të ndalet rënia e shoqërisë dhe e shtetit".





INTERVISTË ESKLUZIVE me Bardhyl Mahmutin: Si u hoq cilësimi i UÇK-së si “organizatë terroriste”? (20)

Qeveria e Përkohshme dhe përfundimi i luftës

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së njëzetë, ka folur për krijimin e Qeverisë së Përkohshme, e cila i dha fund përfaqësimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nëpërmjet përfaqësuesve të vet politikë. Bardhyl Mahmuti ka theksuar se shumica e anëtarëve të Drejtorisë Politike dhe të Grupit Diplomatik u sistemuan në detyra të ndryshme të Qeverisë së Përkohshme. Ai ka folur për takimet e delegacionit të Qeverisë së Përkohshme jashtë vendit, ku edhe vetë ishte pjesë e delegacioneve. Bardhyl Mahmuti ka treguar se nga data 14-17 prill 1999 qëndruan për vizitë zyrtare në Francë. Gjatë kësaj kohe ata kanë realizuar 24 takime të rëndësishme në institucione të ndryshme dhe aty nuk munguan duartrokitjet dhe brohoritjet UÇK-UÇK

Prishtinë, 8 janar -
“Epoka e re”: Konteksti që u krijuar gjatë bisedimeve në Rambuje nxori si domosdoshmëri krijimin e një organi drejtues gjithëpërfshirës të forcave politike të Kosovës. Aty u morën vesh për krijimin e Qeverisë së Përkohshme, e cila duhej të fliste me një zë të unifikuar. Cili ishte roli i Drejtorisë Politike të UÇK-së pas mandatit që ju dha z. Thaçi për krijimin e Qeverisë së Përkohshme?

Bardhyl Mahmuti: Krijimi i Qeverisë së Përkohshme i dha fund përfaqësimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nëpërmjet përfaqësuesve të vet politikë. Shumica e anëtarëve

të Drejtorisë Politike dhe të Grupit Diplomatik u sistemuan në detyra të ndryshme të Qeverisë së Përkohshme. Megjithatë, jo rrallë mediet nxirrin në rend të parë rolin që kemi pasur gjatë periudhës së bombardimeve të

NATO-s, kemi përfaqësuar Qeverinë e Përkohshme të Kosovës! Megjithatë, jo rrallë mediet nxirrin në rend të parë rolin që kemi pasur në kuadër të UÇK-së.

“Epoka e re”: Përkundër asaj se ju mbeti hatri nga “loja” me emrat e përfaqësuesve politikë të UÇK-së pjesëmarrës në Konferencën e Rambujesë, ju vazhduat të angazhoheshit në kuadër të Qeverisë së Përkohshme?

Bardhyl Mahmuti: Në kontekst të përmasave të tillë të gjenocidit që përjetonin shqiptarët e Kosovës, nuk kanë vend hatëret dhe teket e njerëzve. Jam përpjekur të jap kontributin tim qoftë në takimet individuale, qoftë në kuadër të delegacioneve të Qeverisë së Përkohshme.

“Epoka e re”: Kush ishte në përbërje të delegacioneve dhe

cilat takime do t'i veçonit ku keni marrë pjesë në kuadër të delegacionit të Qeverisë së Përkohshme?

Bardhyl Mahmuti: Së bashku me Jakup Krasniqin (zëdhënës i qeverisë dhe ministër për Rindërtim) dhe Bilall Sherifin (këshilltar për çështje të politikës së jashtme i kryeministrat Thaçi) nga data 14-17 prill 1999 qëndruam përvizitë zyrtare në Francë. Gjatë kësaj kohe kemi pasur 24 takime të rëndësishme në Ministrinë e Punëve të Jashtme (me ministrin Huber Vedrin); në Presidencë (me sekretarin e presidentit Chirac); në Asamblenë Parlamentare, me Komisionin për Politikë të Jashtme; në Ministrinë e Mbrojtjes dhe përfaqësues të shoqërisë civile, që ishin mobilizuar kundër gjenocidit të Serbisë në Kosovë.

Intelektualët që organizuan *Mitingun e Solidaritetit me Kosovën* na ftuan të merrnim pjesë, por autoritetet franceze kishin frikë për sigurinë e Jakup Krasniqit dhe nuk merrnin përsipër ta shoqëronin. Kështu, në këtë takim, shkova vetëm unë. Në panelin e këtij mitingu

(30 Mar 1999) English/Nat

NATO and the Kosovo Liberation Army staged a show of unity on Tuesday over claims the allied air strikes on Yugoslavia were making things worse, not better, for the people of Kosovo.

British foreign secretary Robin Cook met senior Kosovo Albanian representatives in London, and afterwards both sides insisted it was the Serbs, not NATO, that bore responsibility for the massacres and the growing refugee crisis.

“Every journalist who tries to make a link between NATO military action and the massacres are forgetting the (Serb) policy of genocide in Kosovo. It isn't NATO that has caused the massacres. On the contrary, NATO is trying to prevent ethnic cleansing in Kosovo.”

SUPER CAPTION: Bardhyl Mahmuti, KLA spokesman

ishin shkrimtarët Bernard-Henri Lévy, Gilles Hertzog, eurodeputeti Daniel Cohn-Bendit, filozofi André Glucksmann, Ismail Kadare, Muhamedin Kullashi dhe personalitetë të tjera të jetës politike dhe kulturore të Francës. Në sallën plot e përplot me intelektualë m'u bë një pritje e jashtëzakonshme: Kur më paraqiti organizatori, të gjithë u çuan në këmbë duke duartrokitur dhe brohoritur UÇK-UÇK!

udhëtonim për në Bon nëse nuk zyrtarizohej takimi dhe nëse nuk mbahej konferencë me gazetarët. Rreth dy orë më vonë ministri Vedrin më mori në telefon dhe më informoi se keqkuptimet ishin tejkaluar. Dhe ashtu ndodhi: takimi u protokollua dhe konferanca me gazetarë u mbajt në Quaid'Orsay! Takimet vazhduan në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë (me ministrin e Jashtëm, Joseph Martin

qëndrimi ynë rreth këtyre çështjeve. Për lexuesin po veçoj takimin që kemi pasur me zëvendëssekratin amerikan të Shtetit, Strobe Talbott, i cili, së bashku me Viktor Çernomirdin dhe Martti Ahtisaari, përbënë Treshen që negacione ndërprerjen e luftës.

Duke bërë krahasimin se si ishte vepruar në situata analogjike për t'i pamundësuar kriminelit të kthehet në vendin e krimit,

më lart, senatorja belge Anne-Marie Lizin, përvèç që na organizoi një numër takimesh të rendësishme me senatorë belgë dhe një darkë me ambasadorin Daan Everts, i cili në periudhën e paslufës (1999-2001) ishte shefat i Misionit të OSBE-së në Kosovë, zonja Lizinajo na e la në shërbim vilën e saj private gjatë gjithë kohës sa kemi qëndruar në Bruksel.

Nga Brukseli unë u ktheva në Zvicër për një takim tjetër, ndërkaq kryeministri Thaçi dhe këshilltari për çështje të politikës së jashtme, Bilall Sherifi, vazhduan për Londër, në takim me ministrin e Jashtëm të Britanisë së Madhe, Robin Cook.

"Epoka e re": Të ndalemi te një detaj! Pas përfundimit të luftës, Serbisë iu ndalua t'i afrohej kufirit administrativ të Kosovës në një distancë prej 5 km. A mendoni se në këtë vendim ka mundur të ndikojë kërkesa juaj?

Bardhyll Mahmuti: Nuk kam asnjë mundësi të verifikoj një hipotezë të tillë. Sidoqoftë, kërkosat tona dëshmonin për qasjen serioze të angazhimeve të Qeverisë së Përkohshme për t'i dhënë fund një herë e përgjithmonë rrezikut të destabilizimit të kësaj pjese të Evropës Juglindore.

policore) nga Kosova. Një ditë pas kësaj marrëveshje, më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244, nëpërmjet së cilës përcaktohej korniza juridike e pranisë civile ndërkombëtare dhe e sigurisë në Kosovë deri në përcaktimin e statusit politik përfundimtar. Kjo marrëveshje i dha fund luftës në Kosovë!

Bardhyll Mahmuti: Përfundimi i luftës në Kosovë hapi "dyert e teatrit" ku ishte vënë në skenë gjenocidi kundër shqiptarëve.

Të parët që u kthyen në vend ishin "aktorët" që në këtë "skenar tragjik" përbënë kolonat e spastrimit etnik. Për shkak të afersisë gjeografike, të dëbuarit që kishin gjetur strehim në viset e banuara me shqiptarë në Maqedoni, në Shqipëri, në Mal të Zi dhe në Bosnjë u kthyen javën e parë, ndërsa qindra mijëra të tjera u kthyen nga shtetet e demokratice perëndimore, në veçant nga Zvicra, Gjermania, Britania e Madhe, Franca, ShBA-ja, Kanada, Australia ku kishin gjetur strehim të përkohshëm dhe trajtim tejet human. Nga data 12 qershor e deri në muajin Gusht të vitit 1999 rreth një milion shqiptarë që ishin dëbuar me dhunë u kthyen në Kosovë.

Ata gjetën një vend të rrënuar.

Pasojat e gjenocidit në Kosovë ishin shumë të mëdha. Krasa numri i madh të vrarëve dhe të zhdukurve, numri që dikujt mund t'i duket i vogël nga këndvështrimi i tij "negacionist", në Kosovë ishin shkatërruar "100 589 shtëpi, 358 shkolla, 30 shtëpi kulture, 93 biblioteka, 123 institucione shëndetësore, 220 objekte të kultit fetar (215 xhami, teqe, tyrbë dhe 5 kisha katolike)...".

(Muhamet MAVRAJ / Vijon)



Në këtë rast vlen të theksohet se për organizimin e këtij mitingu një rol jashtëzakonisht të madh kanë luajtur Ismail Kadare dhe Muhamedin Kullashi!

Një muaj më vonë, saktësisht më 26-30 maj, së bashku me kryeministrin Thaçi dhe këshilltarin për çështje të politikës së jashtme, Bilall Sherifi, patëm një varg takimesh të një rëndësie të veçantë në Paris, në Bon dhe në Bruksel.

"Epoka e re": Në çfarë niveli ishin takimet e juaja?

Bardhyll Mahmuti: Takimi i parë në nivel ministror ishte paraparë të bëhej me ministrin e Jashtëm francez Huber Vedrin dhe rreth këtij takimi na dolën disa telashe. Nëpërmjet miqve që kisha në Paris arrita të kuptoj se takimi me ne nuk figuronte në protokollin e kësaj ministrie dhe nuk ishte paraparë të mbahej konferencë me gazetarët. Menjëherë këruam sqarime. Kur e kuptuan se ne ishim në dijeni të asaj çfarë shkruhej në protokollin shtetëror, u vërejt hidhërimi i ekpit që preokupohej për sigurinë tonë në hotel! Ne refuzuam t'i pranonim arsyetimet e tyre se një gjë e tillë ishte bërë për çështje sigurie dhe i njoftuam se të nesëmen do të

delegacioni i Kosovës mori shembullin se si iu ndalua Irakut zona ajrore në jug të paraleles 32, që përfshinte një territor prej 140 mijë km² (sa 13 herë territori i Kosovës) dhe kërkoi që të veprohet në mënyrë të njëjtë edhe me Serbinë, duke ua ndaluar forcave serbe t'i afrohesin Kosovës në një distancë tokësore dhe ajrore prej 20 km. E ndiej si obligim të ndaj me lexuesin edhe një fakt. Mikesha e Adem Demaçit, që u përmend

"Epoka e re": Pas sulmeve të pandërprra ajrore të NATO-s kundër caqeve të forcave të armatosura serbe, nga 24 marsi 1999 deri më 9 qershor 1999, regjimi i Sllobodan Milosheviqit u detyrua ta nënshkruajë "Marrëveshjen Ushtarako-Teknike" në Kumanovë, e cila shënoi fundin e strukturave politike të pushtetit të instaluar nga Milosheviqi në Kosovë dhe tërheqjen e forcave të armatosura (ushtarake) dhe

Fischer, i njohur si Joschka Fischer); në selinë e NATO-s në Bruksel (ku takuam komandantin e përgjithshëm të NATO-s, gjeneralin Wesley Clark dhe një grup të ambasadorëve të NATO-s, të cilëve iu printe ambasadori amerikan Alexander Vershbow).

Në të gjitha takimet e shtë diskutuar rreth modaliteteve të tërheqjes së pushtetit politik dhe forcave të armatosura serbe nga Kosova dhe kërkohje



Vuçiçi thotë se BE-ja po i kërkon Serbisë ta njohë pavarësinë e Kosovës

PRISHTINË, 8 JANAR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, tha se Evropa po i kërkon Serbisë ta njohë pavarësinë e Kosovës. "De facto ose de jure, kjo po kërcohët. Le të mos gënjejmë për këtë gjë. Fuqia më e madhe, Bashkimi Evropian, po e kërkon këtë", tha Vuçiç për televizionin "Pink".

Duke folur lidhur me atë nëse

qytetarët e Serbisë mund të pajtohen që shteti të futet në BE, Vuçiç tha se është përkëtë gjë, por gjysma e qytetarëve janë për dhe gjysma tjetër kundër hyrjes në BE. Ai, po ashtu, tha se qytetarët e Serbisë nuk pajtohen sa i përket Kosovës. "Ne mund ta gënjejmë veten se kemi pajtim përkëtë çështje. Sigurisht që nuk



BE-ja: Ky vit sjell shpresë të re për zbatimin e marrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 8 JANAR - Bashkimi Evropian (BE) thotë se ka shpresë që këtë vit Kosova dhe Serbia t'i zbatojnë marrëveshjet e arritura deri tani në dialogun e ndërmjetësuar nga blloku, duke ngulur këmbë se ato janë të detyrueshme dhe se duhet të zbatohen në tërsësi nga të dyja palët.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, tha të hënën në Bruksel se fillimi i zbatimit të marrëveshjes përtargat këtë javë mes dy vendave tregon se "kur ka vullnet nga palët, atëherë edhe përparimi është i mundur".

Kosova dhe Serbia njohën edhe zyrtarisht targat e njëra-tjetrës, duke mos e zbatuar nga 1 janari regjimin e letrave ngjitet që mbulonin simbolet shtetërore në targa kur automjetet lëviznin në territorët e tyre përkatëse. "Puna në dialog vazhdon dhe fokusi është në implementim të asaj që është arritur pajtim në Bruksel dhe më pas në Ohër vitin e kaluar. E pamë në rastin e njohjes së targave të veturave se progresi është i mundur. Palët u pajtuan për zbatimin e vendimit përtargat", tha Stano.

Ai theksoi se BE-ja do të punojë përtu' ndihmuar palëve t'i zbatojnë ato përfshirë janë zotuar dhe e përsëriti se ato janë të detyrueshme përpali.

Blloku prej 27-vendesh e ndërmjetëson prej vitit 2011 dialogun përtightim i marrëdhënive mes Kosovës dhe Serbisë.

Vitin e kaluar Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen në rrugën



drejt normalizimit të marrëdhënive dhe aneksin përzbatimin e saj. Pavarësisht prej trynisë ndërkombëtare që palët ta zbatojnë marrëveshjen, blloku evropian ka thënë se ajo nuk po zbatohet.

Në pyetjen se çfarë mjetesh ka BE-ja përtak bindur Serbisë që ta zbatojë marrëveshjen, pasi ajo është shprehur se nuk do t'i zbatojë disa pjesë të saj, Stano tha të hënën se Serbia ka zgjedhur si orientim integrimin në BE dhe në rast të dështimit në zbatimin e detyrimeve, do t'i rrezikohej ky proces. "E dimë se ka edhe çështje të tjera që Serbia

duhet t'i përbushë në procesin e integrimeve e jo vetëm Kosovën. Por, një më shumë do ta bëjë rrugëtimin edhe më të vështirë", tha ai.

Marrëvesha përtightim, prej 11 nenesh, mes të tjerash, parashevë edhe një nivel të vetëmenaxhimit përkununët serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beograd që t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të dialogut.

Shtetet e Bashkuara kanë thënë vazhdimisht që dialogu për

normalizimin e raporteve duhet të përbillyt me njohje të ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Komuniteti ndërkombëtar vazhdimisht i ka kërkuar Kosovës ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe që do t'i duhej t'u jepte vendimmarrje më të madhe serbëve në Kosovë.

Një draft-statut për Asociacionin iu paraqit Kosovës dhe Serbisë në tetor nga përfaqësuesit e BE-së, Shteteve të Bashkuara, Francës, Gjermanisë dhe Italisë. Megjithatë, së fundmi,

kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ai dhe disa ministra të tij do ta shkruajnë draft-statutin për Asociacionin. Në lidhje me masat ndëshkuese që BE-ja i ndërmori ndaj Kosovës vitin e kaluar, pas rritjes së tensioneve në veri të vendit kur kryetarët shqiptarë u vendosën në zyrtarët e tyre në katër komunat me shumicë serbe pas zgjedhjeve të kundërshtuara dhe bojkotuara nga serbët lokalë, Stano tha se ato do t'i hiqen "kur të vlerësohet se janë ndërmarrë hapat e duhur përshtensionimin e situatës në veri të Kosovës".

Ai theksoi se blloku është duke e vëzhguar situatën në terren dhe duke punuar bashkë me partnerët përtak parë nëse janë ndërmarrë masat e duhura.

Muajin e kaluar presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se ka prirje nga disa vende përtakëndësor masat që blloku i vendosi në fillim të këtij viti ndaj vendit të saj, përtak "kushtëzuar atë përshtetje plotësish të tjera". "Sa iu përket masave, ato është dashur të hiqen moti, në fakt nuk është dashur të vendosen kurrë, përkundër mospajtimeve që kanë ekzistuar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe partnerëve në BE sa i përket 26 majit", tha Osmani.

Ajo nguli këmbë se Kosova i ka plotësuar kushtet përtak heqjen e masave, duke thënë se "ato që janë kërkuar nga Kosova përtak ato që e quanin deeskalim kanë ndodhur".

55 aksidente në Kosovë në 24 orët e fundit

PRISHTINË, 8 JANAR - Gjatë 24 orëve të kaluara janë evidentuar gjithsej 55 aksidente në trafikun rrugor. Policia e Kosovës me zyrtarët e saj janë duke kryer aktivitete në terren me qëllim që të parandalohen aksidentet rrugore, por edhe është duke ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj atyre

personave që nuk respektojnë rregullat dhe shenjat në trafik.

Gjatë 24 orëve të kaluara në këtë fushëveprim në nivel vendi janë realizuar 545 pika kontrolli të automjeteve, përdërisa 34 shoferëve u janë konfiskuar patentëshoferi përtak shkelje të ndryshme të rregullave të trafikut. "Apelojmë tek të

gjithë shoferët, por edhe pjesëmarrësit tjerë në trafik që të janë vigjilent dhe gjatë pjesëmarrjes në rrugë të respektojnë dispozitat ligjore që burojnë nga ligji mbi trafikun rrugor, në mënyrë që secili të kontribuon në zvogëlimin e statistikave të aksidenteve rrugore", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Bujqit gjermanë i bllokojnë rrugët, protestojnë kundër ndaljes së subvencioneve

BERLIN, 8 JANAR - Bujqit gjermanë e filluan një javë protestash gjithëkombëtare duke i bllokuar rrugët me traktorë të hënën për t'i kundërshtuar planet e qeverisë për ndaljen graduale të subvencioneve bujqësore.

Kolona të traktorëve dhe kamionëve, disa prej të cilët me afise të vendosura përparrë me mbishkrin "Pa bujq nuk ka ushqim e as të ardhme", u vendosën nëpër rrugët gjermane në temperaturë minus zero.

Në Berlin dhjetëra traktorë të vendosur në rresht pamundësuan hyrjen në rrugën që dërgon drejt portës Brandenburg.

Policia tha se u bllokuan rrugët



dhe hyrjet në autostrada në shumë pjesë të Gjermanisë, duke shkaktuar komunikacion

në trafik gjatë orës së pikut të mëngjesit. Bujqit janë zotuar se do ta

bllokojnë komunikacionin kryesor dhe rrugët logistike për një javë, duke thënë se heqja e lehtësimave tatinore do t'i detyrojë bujqit ta braktisin punën e tyre.

Joachim Rukwied, kryetar i Shoqatës së Bujqve të Gjermanisë (DBV), u kërkoi qytetarëve mbështetje. "Ne nuk duam ta humbim përkrahjen dhe solidaritetin që e kemi marrë nga një pjesë e madhe e popullit, por ne nuk do ta pranojmë rritjen e planifikuar të tatimit për sektorin e bujqësisë", tha ai për revistën "Stern" të hënën.

Kritikat e bujqve e nxitën javën e kaluar koalicionin e kancelarit Olaf Scholz, i cili është përgjegjës i finalizojë draftin përbuxhetin e

vitit 2024 pasi ishte vonuar nga një vendim gjykate - të bëjë ndryshime të papritura, përfshirë ndryshimin e planeve për heqjen e subvencioneve përbujqësinë.

Në vend se t'i japë fund papritmas uljes tatinore për naftën e përdorur në bujqësi, qeveria planifikon që subvencionet të ulen për 40 % këtë vit, për 30 % më 2025 dhe do të hiqen plotësisht më 2026. Qeveria, gjithashtu, hoqi dorë nga planet për t'i dhënë fund trajtimit të privilegjuar përtatimet në automjete përbujqësinë dhe pylltarinë. Por, DBV-ja tha se këto ndryshime nuk mjaftojnë dhe se protestat do të mbahen këtë javë.

Çmimet e larta, ekspertët kërkojnë politika më të mira fiskale që të bie inflacioni

PRISHTINË, 8 JANAR - Inflacioni gjatë vitit 2023 ka shënuar rënje, mirëpo çmimet nuk janë kthyer siç kanë qenë para kohës së pandemisë. Me një pagë minimale qytetari nuk mund ta mbushë shportën e konsumit as për një gjysmë muaji. Kështu vlerësojnë njohës të ekonomisë, të cilët kërkojnë nga qeveria që gjatë këtij viti të krijojë politika më favorizuese përbuzneset të cilat ndikojnë te rritja apo ulja e çmimeve. Çmimet e konsumit shkuan në 2.9 për qind vjetore dhe -0.1 për qind mujore. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), çmimet janë rritur dhe është "rënduar" për 2.9 për qind më shumë shporta e qytetarit gjatë muajit nëntor 2023 krahasuar me muajin nëntor 2022.

Ndërsa njohësi i ekonomisë, Besnik Avdiu, thotë se, pavarësisht se vitin që lamë pas kishte rënje të inflacionit, çmimet nuk janë kthyer në nivelet e para të pandemisë dhe krisës së luftës në Ukrainë. "Ashtu edhe siç është pritur nga viti 2022, kemi parë një lehtësim deri-diku të çmimeve dhe inflacionit, pavarësisht se kanë arritur në shifra rekordë vitin e kaluar, në vitin 2023 kanë parë

një lloj stabilizimi. Kjo gjë ka sjellë deri te krijimi i një lloj qëndrueshmërie financiare në vendin tonë. Megjithatë, çmimet nuk janë ulur dhe nuk janë kthyer në nivelet e para pandemisë dhe para krisës së luftës në Ukrainë. Tashmë kësaj po i kontribuon deri-diku edhe kriza në Lindjen e Mesme ndërmjet Izraelit dhe Hamasit. Në fillim të kësaj krise kemi parë një rritje të lehtë të çmimeve në tregun ndërkombëtar të naftës. Se inflacioni ka shënuar rënje thotë edhe njohësi tjetër i ekonomisë, Mustafë Kadriaj, teksha shton se me një pagë minimale qytetari nuk mund ta mbushë shportën e konsumit as për një gjysmë muaji. "Nëse marrim parasysh krahasimin mes vitit 2022 me vitin 2023, ka një trend të uljes të inflacionit, përfaktin që kemi pas edhe rënje të inflacionit këtë vit jo shumë për t'u dëshiruar por, sidoqoftë, ka pasur një rënje. Por, ka nevojë më shumë, sepse në bazë të asaj që po shihet, fuqia blerëse e parasë dhe portofolit të qytetarit ka rënë dhe, përfat jo të mirë, kjo valutë monetare që është euro, ka qenë e ngarkuar dhe e rëndësishme edhe përvitit 2023. Me pagën



minimale qytetari nuk mund ta mbushë shportën e konsumit as përgjysmë muaji. Por, uroj që në vitin 2024 qeveria të ketë politika favorizuese përbuzneset", thotë Kadriaj. Edhe njohësi për çështje të ekonomisë, Nagip Skenderi, thotë se qeveria duhet të krijojë

politika fiskale duke ua hequr barrën doganore bizneseve. "Nga njëra anë kemi rënje të inflacionit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe kemi pasur një inflacion dyshifror, mirëpo nga ana tjetër çmimet nuk kanë rënë në produktet baze që janë

ngritur më herët. Përvitit 2024 do të duhej që qeveria përmes subvencioneve të marrë masa adekuata që edhe përmes politikave fiskale, monetare dhe instrumenteve të tjera në aspektin ekonomik t'i stimulojë bizneset, t'u lehtësoj zinxhirin e furnizimit nga jashtë, duke ua hequr barrën doganore", thotë Skenderi.

Sipas raportit të fundit të ASK-së, rritja kryesisht është shpëtuar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pemët 19,4 %, perimet 16,1 %, mallrat dhe shërbimet përbuzneset e zakonshme të ekonomisë shtëpiake 10,8 %, sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe embëlsirat 7,7 %, prodhimet ushqimore 7 %, veshjet dhe këpucë 6 %, pijet alkoolike, duhani 5,9 %, rekreacionet dhe kultura 5,3 %. Po ashtu, energjia elektrike, gazi dhe lëndët djegëse të tjera u rriten 4,8 %, buka dhe drithërat 3,5 %, mallrat dhe shërbimet e ndryshme 2,7 % dhe mishi (1,2 %), dhe me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 3,1-përqindësh në IHCK-it./kp/

Vranica: Gastronomia, më e rrezikuara nga ikja e punëtorëve

PRISHTINË, 8 JANAR - Gastronomia po konsiderohet ndër sektorët që mund të dëmtohet më së shumti me ikjen e punëtorëve jashtë shtetit. Ky sektor ka filluar të marrë punëtorë të huaj, ka thënë për "Ekonomia Online", Arian Vranica nga Shoqata e Gastronomëve të Kosovës.

Ai ka thënë se Kosova qëndron më mirë se shtetet e rajonit sa iu përket

i ka prekur të gjitha vendet. "Realisht shumë sektorë janë prekur nga liberalizimi i vizave si një masë lehtësimi e lëvizjes së lirë të njëzëve, e cila nuk ka ndodhur më herët dhe normalisht që ka ndikuar pak në rritjen e panikut në popull, sepse është një përvjoe e paprovuar në të kaluarën. Pra është hera parë që ballafaqohemi me një realitet të ri. Konsideroj se është një rrjedhje normale siç

i ka prekur të gjitha vendet. Tani po hyjmë në atë vlugun e popujve të cilët migrojnë dhe lëvizin, por kjo do t'i ketë shketësimet e veta, sepse ne si vend nuk jemi parapërgatitur mjaftueshmë që këtë situatë ta amortizojmë në mënyrë të mirë dhe të mundshme. Realisht gastronomia është një ndër sektorët që do t'i preket nga ky lehtësim i lëvizjes", ka thënë Vranica.



Miliarderi dhe Inteligjenca Artificiale: Këtu vendoset fati ynë



Kur njerëzit më të pasur në botë ishin faraonit e Egjiptit të lashtë, sulltani mesjetar Mansa Musa perandori i Malit, Cornelius Vanderbilt dhe John Jacob Astor e John D. Rockefeller, ishte e pamundur të kishte konfuzion, sepse asnëjëri prej tyre nuk u kundërvihje atyre që ne sot i quajmë “fuqi të mëdha”, asnëjëri prej tyre nuk i sfidoi rivalët e vet të biznesit në një luftë në Koloseum, dhe mbi të gjitha asnëjëri prej tyre nuk do të ishte propozuar si një figurë referimi për populizmin që urren elitat. Me pak fjalë, dikur miliarderët ishin elita, dhe pikë. Kohë më të thjeshta, me të pasurit, të lumtur që thjesht janë të pasur. Ndoshta sepse teknologjia ka ndryshuar parametrat e pasurisë, ndoshta sepse me përjashtim të mundshëm të perandorit të Malit, askush në historinë njerëzore nuk ka qenë më i pasur se të pasur e shkullit njëzet e një, ose ndoshta sepse thjesht herët a vonë ka ndodhur që njeriu më i pasur nga të gjithë të bëhej edhe më populisti.

Elon Musk, amerikan i natyralizuar por me originë nga Afrika e Jugut, 52 vjeç, me vlerë 222 miliardë dollarë në dhjetor 2023 (Bloomberg Billionaires Index), ishte bërë i famshëm falë x.com, që më vonë u bë PayPal, faqja e shërbimeve financiare e blerë nga eBay në vitin 2002, për një shumë afér një miliardë e gjysmë dollarë.

Musk, 21 vjet më parë, i befasoi vëzhguesit e Eall Street-it, sepse ai thjesht kishte riinvestuar të gjitha paratë e mbledhura nga eBay – rrëth 100 milionë dollarë – në bizneset e tij të tjera, në vend që të blinte shtëpi, jahte, makina të mëdha si kolegët e tij të “ekonomisë së re” digitale të asaj kohe.

Musku i asaj kohe ishte shumë i ndryshëm nga ai aktuali: më

shumë “nerd” se sa mburravec, i veshur (jo shumë mirë) “casual” dhe larg pamjes “gjithçka e zezë” e viteve të fundit.

Paratë e arkëtuara nga eBay kishin përfunduar në projekte më ambicioze: SpaceX për eksplorimin hapësinor, Tesla për të ndryshuar botën e automobilëve duke përmbysur motorrin e vjetër me karburant, pas dy shekujsh shërbim, kompania Boring për të gjerrmuar tunele me anë të të cilëve të çlironte trafikun, Neuralink për të vendosur në tru mikroçipë, me të cilët të mund të shërojë mundësish një seri të tmerrshme sëmundjesh, nga Alzheimeri tek paraliza, OpenAI për të ndryshuar botën me inteligjencën artificiale. Dhe në kohën e lirë, merrej me robotët e Optimus, me të cilët dëshiron të revolucionarizojë përgjithmonë mënyrën e të punuarit dhe (druhet shumëkush), atë të të bërit luftë.

Lëshonte raketa në hapësirë edhe në emër të NASA-s, furnizues i të cilës ishte bërë. Ai lidhi internetin nëpërmjet satelitëve me Starlink-un e tij, vërtitej me Teslën e tij, duke hapur fabrika në mbarë botën dhe duke thyer një rekord pas tjetrit.

Në vazhdën e famës së tij globale, ai bëri të famshme edhe nënën, Maye, një modele shtatëdhjetëvjeçare dhe zëdhënëse e Moncler.

Por atëherë ndodhi jo tamam rënia – ai bëhet gjithnjë e më i pasur dhe më i fokusuar në media – por metamorfoza. Ose, siç mendojnë të tjerët, më e thjeshta:

shfaqja e karakterit të vërtetë të novorit miliarder. Walter Isaacson, në biografinë e Musk, shkruan: «Në kohën kur po mblidhja materiale për biografinë e Steve Jobs, ma shpjegoi partneri i tij Steve Wozniak, se cila ishte pyetja kryesore për t’i bërë: a ishte vërtet e nevojshme që ai të ishte

kaq i keq, kaq i vrazhdë dhe mizor, kaq i varur nga situata dramatike? Kur, pasi mblodha materialin, u ktheva tek Woz për t’i bërë përsëri pyetjen, ai u përgjigj se nëse do të kishte qenë në krye të Apple, do të kishte qenë më i mirë. Ai do t’i kishte trajtuar të gjithë si një familje e madhe dhe nuk do t’i kishte pushuar njerëzit nga puna.

Më pas, ndaloj dhe shtoi: “Por nëse do të kisha drejtuar Apple, ne nuk do të kishim prodhuar kurrë Macintoshin.” Dhe kështu pyetja, në rastin e Musk, është: nëse ai do të kishte pasur një karakter më të qetë, a do të kishte qenë sërisht njeriu që do të na kishte projektuar drejt Marsit dhe një të ardhmeje me makina elektrike? Bëhet fjalë, në psikologji, për një shembull klasik të arsyetimit: domethënë, përpjekja për të maskuar motivet e vërteta (shiko fabulën e Dhelprës dhe rrushit). Fillimi i Jobs dhe më pas Musk, ishin/janë njerëz me karakter të pamundur? Eshtë çmimi i gjenialitetit të tyre.

Po a është vërtet kështu?

Tipari i spikatur i klubit të shkëlqyer dhe të populluar të tifozëve të Elon Musk është se vërejnë cilësitë e tij – që janë të pamohueshme. Të gjitha të tjerat? Fillimi i jetës së re të Musk, i cili nga “njeriu më i pasur” u bë edhe më i famshmi, është për shkak të blerjes së Tëitter, më 27 tetor 2022, për 44 miliardë dollarë. Lëvizje brilante? Gabim në vlerësim? Sigurisht, 14 muaj më vonë, Tëitter (të cilin e riemëroi X humbet para, Musk është bërë idhulli i republikanëve amerikanë që janë kundër sistemit, fshikullues i George Sorosit, kritik i ashper i të majtës progresiste, i aktivistëve Lgbt, i shoqatës hebraike amerikane me më shumë ndikim, të cilën e akuzon

se e ka armiqësuar me reklamuesit më të mëdhenj të Tëitter/X.

Sepse Musk-ut, i cili një herë e një kohë lëvdohet se nuk bënte reklama në kompanitë e tij, dhe që nuk kishte përdorur asnjëherë për Teslan një zyrë shtypi, për shkak se për marrëdhënien publike kujdeset vetë nëpërmjet mediave sociale dhe intervistave të posaçme, tanë e gjen veten duke drejtuar një biznes, i cili mbështetet mbi publicitetin.

Për nga temperamenti dhe ndoshta edhe nga të qenit pak arrogant, Musk nuk është i zoti në të ardhurat nga reklamat. Madje bëri goxha bujë ajo “fuck ju” që u tha në një konferencë ish-reklamuesve të mëdhenj – si Disney – të cilët po bojkotojnë menaxhimin e ri të Twitter/X, i parë nga shumë njerëz si shumë i butë ndaj dezinformative dhe trollëve të krahut të djathë.

Atëherë ishte e pashmangshme që ata që nuk e donin, do të fillonin t’i përmendnin babanë e sertin dhe minierat e smeraldit në Afrikën e Jugut të aparteidit, gjyshin e tij antisemit, klauzolën kontraktuale që e tregon atë si bashkëthemelues të Tesla-s, edhe

pse ai erdi më vonë në kompaninë që në fund e bëri të tijën, premimet e dështuara në Neuralink që po përpinqet të ngrihet, dhe atë projekt të dështuar në trenat me shpejtësi shumë të lartë, që sipas shumë njerëzve ishte thjesht një dredhi për të bllokuar projektet e shtetit të Kalifornisë në të njëjtën fushë.

Sigurisht, Musk mbetet shumë i mirë në organizimin e ngjarjeve mediatike, të tilla si inaugurimi i Cybertruck, një kamion elektrik anti-mitraloz.

Eshtë e vështirë të mos argumentosh që Musk e sheh veten si Steve Jobs i ri – ai gjithashtu ndan me të biografinë zyrtar, Walter Isaacson – dhe

ndonëse shumëkujt i kujton Pt Barnum, talenti i tij është i padiskutueshëm: ai luan provokuesin e borgjezisë – Bürgerschreck do ta kishin quajtur në Vjenë e një shkulli më parë – dhe qdo instrument cirku është i mirë për t’u angazhuar.

Ai sfidoi Mark Zuckerbergun e Facebook-ut (i cili peshon 70 kg në krasim me 134 të Musk) në një duel-lufte të çuditshëm në Koloseum duke përfshirë fatkeqësish edhe politikën italiane, ai pozon si superhero à la Tony Stark (miliarderi teknologjik i filmave Marvel i cili shndërrohet në Iron Man).


Musk i përket asaj rryme mendimi që fatkeqësish është shumë e përhapur në Silicon Valley e quajtur transhumanizëm, pra aspiratë për ta bërë homo sapiensin një specie shumëplanetare duke na dërguar në Mars me raketa Space X dhe me mikroçipe Neuralink brenda kafkës, për të drejtuar Teslën në planetin e kuq, ndoshta duke i dorëzuar timonin një roboti të drejtuar nga inteligjenca artificiale.

Gjithçka shumë bukur, por kur promovoi nga llogaria e tij në Twitter një postim që akuzonte hebrenjtë se ushqejnë “urrejtje dialektik” për të bardhët, iu desh që për një herë të kërkojë falje (për Sorosin, hebre, vazhdon të thotë gjëra të rënda).

Ish bashkëshortja, këngëtarja Grimes me të cilën ka tre fëmijë me emra të ndërlidhur (XÆ A-Xii, Exa Dark Siderael dhe Techno Mechanicus) thotë se një pjesë e problemeve të Musk burojnë nga Sindroma Asperger – një formë autizmi. “Nëse dikush vuan nga depresioni apo nga kriza të ankthit, të gjithë tregojnë dhembshuri. Nëse dikush ka Asperger, njerëzit thonë thjesht që është një hajvan”.

Motorri i ekonomisë kërkon naftën

Gjigandët energetikë vazhdojnë të mbështeten (dhe fort madje) tek lëndët djegëse fosile, duke gjetur vendburime të reja. Dhe “ëndrrat e gjelbëra” të Evropës duhet të presin



Ndërsa Evropa vazhdon në utopinë e saj të dekarbonizimit me detyrim, gjigantët e naftës ende besojnë se fundi i karburanteve fosile i përket librit të ëndrrave të Bruselit. Dhe vazhdojnë rrugën e tyre. Në botën e energjisë është krijuar një hendek midis politikave të ndjekura nga institucionet ndërkombëtare, plot me qëllime të mira për shpëtimin e planetit, dhe realitetit të ekonomisë botërore, e cila, për të ecur përpara, për të krijuar zhvillim, për të përmirësuar kushtet e jetesës, ka ende nevojë për naftë dhe gaz, dhe për këtë arsy e është gjithmonë e nevojshme kërkimi dhe nxjerra e tyre.

Alberto Clò, ekonomist dhe studiues autoritar i botës së energjisë, reflekton: “Evropa e gjen vreten të shtypur, mes frontit lindor me luftën e Ukrainës, e cila ka pasoja në furnizimet me gaz, dhe jugut, me luftën e Lindjes së Mesme që na tregon se sa rëndësi ka ende nafta. Bruseli bën sikur nuk i vëren çështjet kritike në lidhje me furnizimin me energji. Pas 7 tetorit çmimet e gazit u ritën deri në 50 për qind dhe kjo do të ketë pasoja në kostot përfundimtare të energjisë elektrike dhe gazit, deri në çmimë të mbrojtura”.

Gjigantët e naftës e dinë mirë këtë situatë dhe vazhdojnë të kenë naftën dhe gazin si biznesin e tyre kryesor, nga i cili nxjerrin përqindjen më të lartë të fitimeve. Kjo shpjegon megablerjen nga Exxon Mobil të konkurrentit Pioneer Natural Resources. Bashkimi, me vlerë 59.5 miliardë dollarë, e vendos prodhuesin amerikan të naftës dhe gazit në kontroll të vendburimit më të madh në Shtetet e Bashkuara. Chevron, gjiganti kalifornian që bleu Hess-in, lëviz me shpejtësi në

një transaksion aksionesh me vlerë 53 miliardë dollarë. Me këtë operacion, prodhimi i Chevron do të rritet me më shumë se 10 për qind. Në tremujorin e dytë, kompania kaliforniane prodhonte pothuajse 3 milionë fuçi naftë në ditë, ndërsa prodhimi i Hess arriti në 387,000 në të njëjtën periudhë. Kjo e fundit është shumë aktive edhe në Guajana, ku ka 30 për qind të aksioneve në një kompani kërkimi nafte dhe llogaritet se në vitin 2024, do të arrijë në 480 mijë fuçi në ditë.

Në katër vitet e fundit, Exxon dhe Hess kanë bërë mbi 30 zbulime në shtetin e Amerikës së Jugut dhe Hess identifikoi një depozitë të madhe në Gjirin e Meksikës, në vitin 2023. Dy operacione që nuk janë parë në më shumë se njëzet vjet dhe, në mënyrë paradoxale, pikërisht në kohën kur fushata për energjitet e rinovueshme po merr vrull. Dhe nuk janë të vetmit. Reuters shkroi se prodhuesi i gazit Chesapeake Energy po konsideron blerjen e Southwestern Energy.

Gjigantët amerikanë janë të bindur se kërkesa për lëndë djegëse fosile do të mbetet e lartë për një kohë të gjatë. Dhe këtë e thotë edhe OPEC, në World Oil Outlook 2023. Kërkesa globale do të arrijë në 116 milionë fuçi në ditë deri në vitin 2045 (në 2022 ishte 99.6). Në vitin 2028 duhet të arrijë në 110.2 milionë fuçi në ditë, pra +10.6 milionë në krahasim me vitin 2022. Për më tepër, është një skenar i matur, i cili duhet vënë në pikëpyetje nëse rritja ekonomike e Indisë, Kinës, Afrikës dhe Lindjes së Mesme përshtapjetohet. Sekretari i Përgjithshëm i OPEC-ut, Haitham al-Ghais fton Evropën të bëjë një dush realizmi. “Thirrjet për të ndalur investimet në

projektet e reja të naftës janë të gabuara dhe mund të çojnë në kaos energetik dhe ekonomik.” OPEC pretendon se investimet në sektorin e naftës që arrijnë në 14 trilion dollarë, do të nevojiten për të përbushur parashikimet afatgjata të kërkuesës, rreth 610 miliardë mesatarisht në vit. Skenari i përshkruar nga IEA, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, është i një natyre tjetër, ai shpreh bindjen se jemi “në fillim të fundit” të epokës së karburanteve fosile. Sipas parashikimeve të tij, kërkesa për qymyr, naftë dhe gaz do të arrijë kulmin përpara vitit 2030 dhe konsumi i burimeve tradicionale

do të ulet me hyrjen në fuqi të politikave klimatike. Por duke qenë se jemi ende larg objektivit për të reduktuar ngrohjen globale me 1.5 gradë Celsius në krahasim me nivelet para-industriale, duhet bërë më shumë.

Një tjetër konfirmim se si po ecën sektori vjen nga një raport i Greenpeace: në vitin 2022 vetëm 0.3 për qind e prodhimit të 12 furnizuesve kryesorë evropianë të lëndëve djegëse fosile vinte nga burime të rinovueshme. Vitin e kaluar, rreth 7.3 për qind (d.m.th. 7.1 miliardë dollarë) të investimeve të kompanive të pyetura, shkuan në këtë lloj energjje, ndërsa rreth 88.15 miliardë dollarë financime shkuan për operacionet e karburanteve fosile.

Marsin e kaluar, administrata amerikane e udhëhequr nga Joe Biden, i cili gjithashtu flet shumë për respektin ndaj mjedisit, miratoi projektin e naftës Willow të ConocoPhillips, i cili përfshin shpimin në tre zona në Rezervën Kombëtare të Naftës, në Alaskë, për të arritur nxjerrjen e 629 milionë fuçi naftë bruto gjatë 30 viteve të ardhshme. Grupet amerikane ende ndjekin strategjinë “nafta e para”.

Norvegjia, vendi më i rëndësishëm prodhues i naftës dhe gazit në Evropë, vazhdon të kërkojë depozita të reja. Këtë vit, do të shpohen 35 puse eksploruese, duke u rritur në 36 në vitin 2024. Jez Averty, nënkyetar Equinor për burimet nëntokësore, specifikoi se strategjia është të “sigurojë që platforma kontinentale norvegjeze të nxjerrë pikat e fundit, fuçitë e fundit për t'i mbijetuar konkurrencës.”

Vendi skandinav, edhe pse

akordon fonde të konsiderueshme për zhvillimin e burimeve të rinovueshme dhe ka potencialin të mos përdorë lëndë djegëse fosile, vazhdon me realizëm të madh në kërkimin të depozitave detare. Investimet në industrinë e naftës dhe gazit të Norvegjisë në Detin e Veriut do të arrijnë një rekord prej 21 miliardë dollarësh këtë vit. Sektori i naftës kontribuon afersisht për 40 për qind të eksporteve të vendit dhe 14 për qind të PBB-së së tij. Do të ishte e pamatur të hiqje dorë prej saj.

Analistët në Scope Ratings përshkruajnë këtë skenar: «Grupet evropiane po zgjedhin rrugë të ndryshme sepse nuk ka konsensus se kur do të fillojë kalimi në karburantet me emetim të ulët, për të reduktuar kërkësën globale për naftë. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë pret që kjo të ndodhë deri në vitin 2030, OPEC pas vitit 2035, Administrata e Informacionit të Energjisë së SHBA-së jo para vitit 2050. Pra, grupet e integrarë të naftës dhe gazit po i përshtaten naftës”.

Evropa duket indiferente ndaj asaj që po ndodh, me besimin se burimet e rinovueshme janë ilaçi për të gjitha sëmundjet. Gazi dhe nafta përfaqësojnë mbi 50 për qind të konsumit të energjisë dhe janë faktorë kritikë që do të ndikojnë në çmimet përfundimtare dhe inflacionin. Ne harrojmë se që nga viti 2005, gjashtë mijë miliardë janë investuar në burimet e rinovueshme që përfaqësojnë më pak se 5 për qind të konsumit total të energjisë, ndërsa lëndët djegëse fosile përbëjnë ende 82 për qind të nevojave. Kemi nevojë për realizëm që të mos vazhdojmë të dëmtojmë veten. | (bota.al)





Tshimanga, MVP i javës në Superligën e basketballit

MITROVICE, 8 JANAR - Në një dramë të vërtetë Trepça mundi Sigal Prishtinën, duke fituar derbin e kësaj xhiro. Pikërisht nga ky derbi vjen edhe MVP i javës së 16-të. Jordy Tshimanga i vendasve ishte më i dalluar në parket

me dyshifr të dyfishtë, 20 pikë e 15 kërcime, duke u zgjedhur për herë të parë më i miri i javës në këtë edicion. Ai u ndihmua nga Drilon Hajrizi me 17 pikë, pesë kërcime dhe dy asistime. Justin Davis i Pejës zhvilloi një tjetër

ndeshje të madhe, kësaj radhe ndaj Proton Cable Prizrenit, duke e mbyllur ndeshjen me 30 pikë, 12 kërcime dhe pesë asistime. Golden Eagle Ylli mundi Istogun, kurse më i dalluar te therandasit ishte Jalen

Nesbitt me 23 pikë, 13 kërcime dhe një asistim. Bashkimi shënoi fitore shumë të rëndësishme ndaj Vellaznimit, kurse te prizrenasit më i miri ishte Erik Copes me 23 pikë, shtatë kërcime dhe një asistim.



Ndërron jetë legjenda Franz Beckenbauer

Bota e futbollit është në zi. Në moshën 78-vjeçare ka ndërruar jetë Franz Beckenbauer. Legjenda gjermane në vitin 2011 ishte dekoruar me titullin "Ambasador Nderi" i Kosovës. Ish-ylli i Bayern Munchen ka qenë një ndër të rrallët që e ka fituar Kupën e Botës si lojtar dhe si trajner

"Epoka e re"

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Legjenda e futbollit gjerman Franz Beckenbauer ka ndërruar jetë në moshën 78-vjeçare. Lajmin përikeni në amshim për njërin prej lojtarëve më të mirë në histori të futbollit e ka bërë familja e tij. "Me pikëllim të thellë njoftojmë se bashkëshorti im dhe babai ynë, Franz Beckenbauer, ndërroi jetë i qetë dje në gjumë, i rrëthuar nga familia e tij. Ne kërkojmë nga ju që të vuajmë humbjen e tij në heshtje dhe të përbaheni nga pyetjet", ka thënë gruaja e Beckenbauerit. Ish-ylli i Bayern Munichut, ka qenë një ndër të rrallët që e ka fituar Kupën e Botës

si lojtar dhe si trajner, së bashku me Didier Deschamps të Frances dhe Mario Zagallo të Brazilit. Beckenbauer i cili gjatë kohës sa ishte futbollist aktiv e kishte pasur nofkën Der Kaiser (perandori) është paraqitur në 103 ndeshje përi sh-Gjermaninë Perëndimore dhe ka luajtur në tre Kupa të Botës. Beckenbauer ishte kapiten i Gjermanisë në Kupën e Botës në vitin 1974, aty ku e mposhtin Holandën në finale me rezultat 2-1. Legjenda gjermane në vitin 2011 ishte dekoruar me titullin "Ambasador Nderi" i Kosovës. Kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli që në atëkohë ishte president i Kosovës, pas vdekjes së Beckenbauerit ka reaguar edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, nëpërmjet një postimi në "Facebook". "Kaiser Franz ishte



Franz Beckenbauer
1945 - 2024

Kosovës Franz Beckenbauer. Njëri ndër më të mëdhenjtë e futbollit në botë, u dekorua në 2011 me titullin "Ambasador Nderi" i Kosovës. Pas vdekjes së Franz Beckenbauer ka reaguar edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, nëpërmjet një postimi në "Facebook". "Kaiser Franz ishte

si një valltar i dalë nga koreografitë e mjeshtreve të baletit modern në qendrën e mbrojtjes së Gjermanisë, ku ngriti Kupën e Botës e më pas, si një personazh i letërsisë gjermane në këmbë përparrë stolit të Bundesmannschaft-it, kur e udhëhoqi Gjermaninë drejt një

tjetër Kupe të Botës. Me ikjen e tij shuhet një tjetër legjendë e gjallë e sportit më të dashur në botë dhe shkëputet një tjetër copë e bukur e fëmijërisë sonë, atëherë kur futbollli ndërkombëtar ishte vetë bota në Shqipërinë e burgosur brenda mureve të komunizmit", ka shkruar Rama.

Pochettino: Broja është një nga lojtarët me më shumë potencial në Evropë



LONDËR, 8 JANAR - Armando Broja realizoi një gol tepër të rëndësishme për ekipin në FA Cup, duke e ndihmuar në kualifikimin ndaj Prestonit. Ishte goli i dytë në një sezoni tepër të vështirë për shkak të dëmtimit e konkurrencës, ndërsa fati i tij mbetet i paqartë. Trajneri Pochettino nuk i ka kursyer elozhet për të. "Goli ishte i rëndësishëm për të. Gjithsesi, dua të jem i ndershëm. Ai duhet ta shfrytëzojë këtë hap, këtë gol

që shënoi, për t'u përmirësuar. Ai duhet të përmirësohet jo vetëm në aspektin e formës, apo të shënimit të golave, por duhet të përmirësojë edhe atë që quhet 'gjuha e trupit'. Ai duhet të hedhë hapa të tjerë, duhet të buzëqeshë më shumë, të jetë më shumë pozitiv. Potenciali i tij është i mahnitshëm. Ne po flasim për një nga sulmuesit e rinj me potencialin më të madh në Angli dhe në Evropë. Ai duhet të bëjë një sforco. Ne do ta

ndihmojmë që ta kuptojë që të mos kënaqet asnjëherë", ka thënë argentinasi. "Gjithsesi, duhet të them se ai po vuani dëmtimin e madh që pati në të kaluarën. Ishte gati një vit jashtë fushe, dhe është e qartë që ai ka nevojë për kohë. Nuk është e lehtë për të që të jetë në atë nivel që ne kërkojmë. Pritshmëria jonë ndaj tij është shumë e madhe dhe ne do ta nxisim që të ngjitet më lart", u shpreh tekniku i "londinezëve".

Zhegrova po vëzhgohet nga disa klube të Bundesliga

LILLE, 8 JANAR - Edon Zhegrova e ka arritur kulmin e karrierës. Ylli kosovar po shkëlqen në fanellën e Lillet në Francë. Ai e nisi vitin 2024 në mënyrë fantastike me tre gola dhe dy asistime në ndeshjen e Kupës

së Francës. Dhe, kjo ka bërë që klubet evropiane të zgjognë interesim për "Messin e Kosovës". Gazetari sportiv gjerman Florian Plettenberg raporton se përfaqësuesit kosovar ia kanë vënë syrin

klubet e Bundesliga. Sipas tij, disa klube gjermane janë duke e monitoruar ish-futbollistin e Baselit, të cilin e duan qysh në janar. Synim i tij është që të luajë në Top 5 klubet gjermane, jo më

poshtë. Natyrisht, për të ka interesime edhe në ligat tjera më të forta evropiane, ndërsa vjet atë e pëlgente edhe Milani në Itali. Kartoni i yllit kosovar vlerësohet 17-20 milionë euro.



Afati kalimtar në hendboll deri më 15 janar

Prishtinë, 8 janar - Është hapur afati kalimtar i janarit në hendbollin kosovar. Lojtarët mund të ndërrojnë

skuadrat nën kushte të caktuara, ndërsa afati dimëror do të jetë i hapur deri më 15 janar. Klube, hendballistë e

hendbolliste të ndryshme kanë paralajmëruar lëvizje dhe ky afat pritet të jetë i pasur. Klubet që pretendojnë titullin

dhe Kupën e Kosovës kanë paralajmëruar ardhje të reja, kërkesat për të cilat duhet të bëhen deri më 15 janar.



Pasuria e Nadalit për vitin 2024 kalon çdo parashikim

MADRID, 8 JANAR - Rafael Nadal është një nga tenistët më të mëdhenj të të gjitha kohëra e dëgjueshëm. Ai është bërë një nga atletët e tenisit më të paguar ndonjëherë. Në fakt, pasuria neto e spanjollit në vitin 2024 besohet të jetë rreth 220 milionë dollarë. Pasi u pengua nga lëndimet në vitin 2023, legjenda e tenisit u kthye në aksion për të myllur vitin. Pasuria neto e Nadal në vitin 2024 është rreth 220 milionë dollarë, sipas burimeve si Celebrity Net Worth dhe Essentially Sports. Shumica e të ardhurave të Nadal vijnë nga të ardhurat e tij duke luajtur tenis. Ai në fakt është i dyti në të gjitha fitimet e karrierës në ATP. Nadal ka fituar më shumë nga çmimet sesa rivali i tij prej kohësh, Roger Federer, i cili ka pak më shumë se 130 milionë dollarë fitime në karierë. Spanjoli gjithashtu ka fituar një mal me para nga sponsorizimet dhe të drejtat tjera të imazhit. Ai është mbështetur



në Kia Motors që nga viti 2006. Nadal është gjithashtu i sponsorizuar nga Nike. Sponsorë të tjerë të Nadalit përfshijnë PokerStars, Emporio Armani, Quely dhe Lanvin. Nadal ishte në kulmin e tij kur erdhë puna për të marrë në shtëpi para të majme

në 2016-17. Vetëm gjatë asaj kohe, ai fitoi mbi 20 milionë dollarë nga imazhi i tij. Ai gjithashtu fitoi 40 milionë dollarë nga fitimet e turneut në vitin 2016. Nadal madje ka një koleksion makinash që vlen mbi 900,000 dollarë.

Lakersat rikthehen te fitorja në derbi, Denveri mposhti Detroitin



Los Anxhelos, 8 janar - Skuadra kampione e Denverit fitoi me lehtësi me rezultat 131-114 ndaj Detroit, ndeshje e komanduar nga vendasit. Murray me 37 pikë ishte shënuar më i mirë në fushë për kampionët. Në krye të renditjes në Perëndim qëndron

Minnesota, që u mund me shifrat 115-108 nga Dallas, në një ndeshje të ekuilibruar. Irving me 5 pikë e Doncic me 34 pikë bënë diferençën në parket për Dallas. Humbet sërisht Golden State, në një sezoni të vështirë. Warriors u mundën në fushën e tyre 131-

118 nga Toronto. Për kanadezët u dallua R.J. Barret me 37 pikë. Rikthehet te fitorja pas pesë humbjes ekipe i Lakersat, që mundi me shifrat 106-103 Clippers në derbin e Los Anxhelos. LeBron James me 25 pikë e Davis me 22 bënë diferençën për Lakersat. Fiton edhe skuadra e Memphisit, që falë 28 pikëve të Jackson mundi 121-115 Phoenixin, ndërsa Portlandin triumfoi me rezultat 134-127 në fushën e Brooklynit. Përmirët u dallua Simons me 38 pikë e 11 rebound.

REZULTATET

Cleveland - San Antonio	117-115
Brooklyn - Portland	127-134
Orlando - Atlanta	117-110
Sacramento - New Orleans	100-133
Dallas - Minnesota	115-108
Denver - Detroit	131-114
Phoenix - Memphis	115-121
Golden State - Toronto	118-131
Lakers - Clippers	106-103

Guardiola: Jemi jashtëzakonisht të kënaqur me rikthimin e De Bruyne

Manchester City mposhti me rezultat 5-0 ndaj Huddersfieldit, kurse në minutën e 57-të hyri në lojë Kevin de Bruyne, i cili u kthye në fushë pas dëmtimit të rendë

në kofshë që pësoi gjatë fillimit të sezonit, duke gjuar jo pak "strategun" e bankinës, i cili nuk mund ta fshihe gjëzimin në fjalët e tij pas ndeshjes. "Ne jemi jashtëzakonisht të

kënaqur që Kevin de Bruyne është rikthyer, sepse ai na ndihmon për të fituar ndeshjet. Është shumë e rëndësishme ta rikthejmë atë pas një dëmtimi të gjatë. Ai do

të na ndihmojë me talentin e tij, por unë nuk dua të lëshoj të gjithë presionin mbi supet e tij, sepse nuk është e drejtë. Ne kemi djem në mesfushë që duan të vrapijnë. Kevin është i

jashtëzakonshëm. Ai është unik. Ne jemi vërtet të kënaqur që është kthyer pas më shumë se tre muajsh me ne. Ai dha një assist shumë të bukur për golin e Doku", ka thënë Guardiola.

SHKURT

Berisha prezantohet te LASK-u

LASK ka bërë të ditur zyrtarisht se kanë transferuar Valon Berishën. Klubi austriak e prezantoi me fanellën e tyre mesfushorin kosovar në ambientet e stadiumit të tyre. Berisha ishte pjesë e Stade Reims, por që mbeti i lirë. Kështu, LASK nuk ka humbur kohë dhe i ka marrë shërbimet e Valonit me parametra zero. Berisha ka nënshkruar me klubin deri në fund të këtij sezoni me mundësi të vazhdimit të kontratës edhe për një vit tjetër.

Hoxha, afër kalimit te Dinamo Zagreb

Futbollisti Arbër Hoxha do të transferohet te gjiganti kroat Dinamo Zagreb, nga Slaven Belupo. Klubet kroate janë dakorduar për shumën e transferimit, teksha Hoxha do t'u nënshtronet testeve mjekësore nesër në Maksimir. Futbollisti kosovar më pas do t'i bashkohet skuadrës përgatitjet në Rovinj. Sipas raportimeve të mediave kroate, Hoxha do t'i bashkohet Dinamos për shumën e një milion eurove. Hoxha mbërriti në Slaven në shkurt të vitit 2022 nga Lokomotiva, e cila e solli nga Prishtina një vit më parë. Ai deri më tanë ka luajtur 63 ndeshje për Slaven dhe ka shënuar 11 gola dhe shtatë asistime. Sipas Transfermarkt, Hoxha vlen 900 mijë euro dhe ka luajtur tri herë për kombëtaren e Kosovës.

Chelsea në bisedime me Dybalan

Paulo Dybala mund të bëhet blerja e radhës për Chelsea, sipas asaj që raportohet nga "Tuttomeratoweb". Klubi anglez ka treguar interesim të lartë për sulmuesin argentinës, duke hedhur sytë nga klauzola e tij e lirimtë e cila do të jetë e disponueshme deri më 15 janar. Sipas raportimeve thuhet se Chelsea është në bisedime të avancuara me Romën dhe është gati të plotësojë shumën prej 15 milionë euro, vlera e klauzolës së lirimtë të Dybala. Përpjekjet e klubit anglez për të siguruar shërbimet e sulmuesit të Romës janë intensifikuar, ku madje janë kryer edhe kontakte të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e lojtarit.

Conte rikthehet në Serie A

Shumë shpejt, Antonio Conte pritet të rikthehet në zejen e trajnerit. Pas një kohe të gjatë, Conte do të kthehet në kampionatin italian, Serie A. Ai është i gatshëm të marrë drejtimin e skuadrës së Napolit. Conte do të vije si zëvendësues i Walter Mazzarrit, i cili do të shkarkohet pas rezultatave të dobëta me napolitanët në dhjetë ndeshjet e fundit. Nën drejtimin e Mazzarrit, Napoli ka tri fitore, gjashtë humbje dhe një barazim. Conte si trajner ka pasur suksesë në Itali, ku është shpallur kampion me Juventusin e Interit. Po ashtu, ka fituar titull edhe në Angli me Chelsean, derisa nuk i eci me Tottenhamin.

